



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT  
(Përfundimtar)**

**PËR**

**MBIKËQYRJEN E PËRGJITHSHME MBI ZBATIMIN E LIGJIT NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL, NË PROCEDURAT E PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TRUPËN E NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES (TND), PËR VITIN 2015**

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE**

**Maj, 2016**

## RAPORT

### *“Për mbikëqyrjen e përgjithshme mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015”*

#### Hyrje

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pikat 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në zbatim të Vendimit nr. 1, datë 06.01.2016, “Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2016” dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, me Vendimin nr. 04, datë 12.01.2016, Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në Departamentin e Administratës Publike, në lidhje me zbatimin e ligjit gjatë zhvillimit të procedurave të pranimit të drejtpërdrejtë, në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015, në institucionet e administratës shtetërore.

Mbikëqyrja u realizua duke ndjekur fillimisht proceset e konkursit, në datat 16 - 19 janar 2016, në ambientet e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, në zbatim të programit të mbikëqyrjes nr. 22/1 prot., datë 12.01.2016, të miratuar nga Komisioneri dhe njoftuar Departamentit të Administratës Publike, me shkresën nr. 22/2 prot., datë 12.01.2016 “Njoftim mbi fillimin e mbikëqyrjes”.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin të gjitha momentet e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore e udhëzimet të dala në bazë dhe për zbatim të tij, të cilat kanë lidhje me procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015; respektimin e kërkesave ligjore gjatë procesit të pranimit për pozicionet e punës objekt mbikëqyrje, në të gjitha fazat e tij.

Mbikëqyrja u realizua duke monitoruar proceset që kanë të bëjnë me, **a)** publikimin e dokumenteve që kanë lidhje me procesin e shpalljes së pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND); **b)** shpalljen e kandidatëve të kualifikuar për të zhvilluar konkurrimin dhe shpalljes së kandidatëve fitues në listën përfundimtare të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes; **c)** fazën e verifikimit paraprak; **d)** vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore; **dh)** fazën e testimit me shkrim; fazën e intervistës së strukturuar me gojë, e aspekte të tjera të zbatimit të ligjit.

Me përfundimit të procesit të konkursit dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i mbikëqyrjes, i përbërë nga inspektorët Saimir Muçmataj dhe Matilda Idrizaj, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe ka përgatitur projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil gjatë procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015.

Pasi u dërgua (me shkresën nr. 22/5 prot., datë 27.04.2016), Projektraporti “Për mbikëqyrjen e përgjithshme mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015”, i

nënshkruar dhe pa observacione të mëtejshme nga Departamenti i Administratës Publike, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, përgatiti “Raportin përfundimtar” në vijim duke u bazuar në objektin dhe qëllimin e mbikëqyrjes.

### **Qëllimi i mbikëqyrjes:**

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjshmërisë gjatë implementimit të instituteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij, në lidhje me procedurat e pranimi të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015.
- Paraqitja para përgjegjësve për menaxhimin e burimeve njerëzore, njësisë së burimeve njerëzore, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi dhe shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil.
- Paralajmërimin e personave përgjegjës dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### **Objekti i mbikëqyrjes:**

1. Si është zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore e udhëzimet të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me procedurat e pranimi të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015.
2. Dokumenti i shpalljes dhe publikimi i tij.
3. Aplikimi, verifikimi paraprak dhe publikimi i dokumentit të shpalljes:
  - a) Aplikimi;
  - b) Verifikimi paraprak;
  - c) Publikimi i verifikimit paraprak dhe përfundimtar.
4. Krijimi, funksionimi dhe kompetencat e Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në.
5. Procesi i konkurrenive dhe shpallja e kandidatëve fitues (*respektimi i procedurave*):
  - a) Testimi me shkrim;
  - b) Intervista e strukturuar me gojë dhe vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve.

### **Referenca ligjore:**

- Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
- Kreu IV (nenet 27 – 32) “Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues”, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014.

- Vendim nr. 118, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar me Vendimin nr. 338, datë 06.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave...”.
- Vendimi nr. 108, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.
- Vendimi nr. 169, datë 25.02.2015, i Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2015”.
- Vendimi nr. 878, datë 30.10.2015, i Këshillit të Ministrave “Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2015”.
- Vendimi nr. 609, datë 17.09.2014, i Këshillit të Ministrave “Për emërimin e tre anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në” dhe Vendimi nr. 525, datë 06.08.2014, i Këshillit të Ministrave “Për emërimin e dy anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në”.
- Vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.
- Rregullore “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- Udhëzim nr. 6, datë 19.09.2014, “Për procesin e rekrutimit dhe të emërimit të nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND”, i Departamentit të Administratës Publike.

### **Metodologjia e mbikëqyrjes:**

Për realizimin e mbikëqyrjes, Komisioneri, me anën e inspektorëve të autorizuar prej tij, ka përdorur këtë metodologji:

- U paraqit në ambientet e ku u zhvillua konkurrimi objekt mbikëqyrje, pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.
- U këqyr faza e verifikimit paraprak, testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë në procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015.
- U monitorua informacioni gjatë zhvillimit të procesit të konkursit, sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare online, të Departamentit të Administratës Publike, në rubrikën “Shpallje për pranim të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civile të nivelit të lartë drejtues TND”.

- U mbajt korrespondencë e vazhdueshme verbale, telefonike, me “e-mail” dhe shkresore, me përfaqësuesit e ngarkuar nga Departamenti i Administratës Publike, për organizimin dhe zhvillimin e konkurrimeve objekt mbikëqyrje dhe iu kërkua, informacioni i nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes dhe sigurimin e dokumentacionit për të kryer hetimin administrativ.

## **Përmbajtja e raportit:**

### **I. Si është zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore e udhëzimet të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2015.**

Bazuar në rregullin e përcaktuar në nenin 27, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pikën 2, germa “b”, të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, numri i anëtarëve në trupën e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues (TND), që do të rekrutohen çdo vit, përcaktohet në planin vjetor të rekrutimit.

Njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore në Kryeministri dhe çdo ministri, hartojnë planin e konsoliduar të nevojave për rekrutim për të gjithë sistemin përkatës, që përfshin aparatën e tyre dhe institucionet e varësisë, ku bëjnë pjesë dhe anëtarët e TND-së dhe nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, brenda muajit nëntor, ia dërgon Departamentit të Administratës Publike. Më tej, Departamenti harton projektvendimin për planifikimin vjetor të pranimit për administratën shtetërore, i cili i propozohet Këshillit të Ministrave nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (sipas pikës 9, të vendimit në fjalë).

Sa më sipër, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 169, datë 25.02.2015, “Për planin vjetor të pranimit në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2015”, ka planifikuar gjithsej 760 vende vakante (ndër këto dhe numrin e anëtarëve të TND-së), të cilët duhet të rekrutoheshin gjatë vitit 2015, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme dhe institucioneve të parashikuara në lidhjen nr. 1 të tij:

a) <u>Për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND):</u>	<b><u>30;</u></b>
b) Për kategorinë e mesme drejtuese:	40;
c) Për kategorinë e ulët drejtuese:	180;
d) Për kategorinë ekzekutive:	510.

Bazuar në nenin 27, pika 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pranimi në trupën e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues (TND), mund të bëhet vetëm nga personat që kanë përfunduar formimin e thelluar në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPА). Deri në daljen e grupit të parë të anëtarëve të TND nga ASPA, apo nëse prurjet me anëtarë të TND-së nga ASPA nuk janë të mjaftueshme, ligjvënësi ka bërë përjashtim duke e materializuar në pikën 5, të dispozitës më sipër, ku përcaktohet se pranimi në trupën e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues (TND), mund të bëhet nëpërmjet një konkursi kombëtar, sipas procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë, e parashikuara nga neni 29, e ligjit në fjalë.

Në mbështetje të nenit 29, pika 1 e 5, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të pikës 2, Kreu V, të Vendimit 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, rezulton se Këshilli i Ministrave, vendos mbi mënyrën e pranimit (nëpërmjet ASPA apo drejtpërdrejtë) në trupën e nëpunësve civil të nivelit të larë drejtues (TND) e po kështu edhe nëse kjo procedurë do të jetë e hapur për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

Bazuar sa më sipër, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 878, datë 30.10.2015, “Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2015”, ka vendosur që për vitin 2015, procedura e pranimit në trupën e nëpunësve civil të nivelit të larë drejtues (TND), të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet një konkursi kombëtar (pika 2, e këtij vendimi) dhe se kjo procedurë do të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil (pika 1, e po këtij vendimi), të cilët plotësojnë kërkesat specifike për pranim në TND, përcaktuar në pikën 4, të këtij akti nënligjor.

Departamenti i Administratës Publike (në vijim, njësia përgjegjëse DAP), në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (në vijim, ASPA), bazuar në përcaktimet e nenit 29, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të pikës 4, të Vendimit nr. 169, datë 25.02.2015, të Këshillit Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2015” dhe pikës 5, të Vendimit nr. 878, datë 30.10.2015, të Këshillit Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2015”, ngarkohet për të organizuar konkursin kombëtar për plotësimin e **30** pozicioneve në trupën e nëpunësve civil të nivelit të larë drejtues (TND).

Rezultoni se në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe nënligjore më sipër, Departamenti i Administratës Publike ka planifikuar dhe organizuar procesin e konkurrimit për plotësimin e **30** pozicioneve në trupën e nëpunësve civil të nivelit të larë drejtues (TND), në mënyrë të ndarë në **2** (dy) procedura konkursi kombëtar, e konkretisht:

- *1 konkurs kombëtar për të plotësuar **1** (një) pozicion “Drejtor i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian”; dhe*
- *1 konkurs kombëtar për të plotësuar **29** (njëzet e nëntë) pozicione në trupën e nivelit të lartë drejtues, të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2015.*

Në përfundim të procedurave të konkurremeve, për plotësimin e **30** pozicioneve në trupën e nëpunësve civil të nivelit të larë drejtues (TND), organizuar nga Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, janë arritur rezultatet si më poshtë:

Numri i pozicioneve që duhet të plotësohen me Konkursset Kombëtare për pranim të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND)	Numri i kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak	Numri i kandidatëve të kualifikuar nga lista përfundimtare (mbas ankesës)	Kandidatët shpallur fitues nga KKP (me mbi 70 pikë)	Numri i anëtarëve të TND mbetur pa plotësuar
1 (një) pozicion “Drejtor i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian”.	1 kandidatë	2 kandidatë	1 kandidatë	-
Numri i pozicioneve të TND, për të cilat do të konkurrohet është 29 (njëzet e nëntë)	56 kandidatë	63 kandidatë	21 kandidatë	8 pozicione

Në përfundim, rezulton se nga **30 pozicione** për t’u plotësuar në trupën e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues (TND), Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes, ka vendosur të shpallë fitues me mbi **70 pikë 22 kandidatë** të suksesshëm, të cilët emërohen në TND, duke mbetur për tu në rishpallur për vitin 2016, sipas nevojave të institucioneve të administratës shtetërore, **8 pozicione**.

## **II. Dokumenti i shpalljes dhe publikimi i tij.**

Akti i shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në përgjithësi dhe për të plotësuar një pozicion në trupën e nëpunësve civil të nivelit të larë drejtues (TND) në veçanti, ka një rëndësi të veçantë. Ai duhet të konceptohet në mënyrë sa më të qartë, të përmbajë të dhëna të plota e të sqaruara me detaje të mjaftueshme në mënyrë që të informojë kandidatët për dokumentacionin që duhet të paraqesë, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave, vendin, kohën e datën që do të zhvillohet konkurrimi etj. Gjithashtu dokumenti i shpalljes duhet të bëhet publik, në mënyrë që konkurrimet kombëtare të bazohen në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe të kryhen nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë.

Komisioneri verifikoi dokumentin e shpalljes, si dhe afatet e shpalljes, në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, sipas përcaktimeve të pikave 4 e 5, të Kreut IV, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar. Gjithashtu, u verifikua zbatimi i përshkrimit të të dhënave që duhet të përmbajë shpallja, të përcaktuara në pikën 6, të Kreut IV, të vendimit më sipër.

Mbikëqyrja u orientua gjithashtu në drejtim të verifikimit të faktit nëse, në aktin e shpalljes ishin të përcaktuara kushtet dhe kërkesat e veçanta, aftësitë, njohuritë e cilësitë, që kandidatët duhet të zotërojnë për të aplikuar në konkurrimin për pranim në trupën e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues (TND). Këto kërkesa janë të parashikuara në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Po kështu janë përcaktuar kërkesat specifike për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, sipas përcaktimeve në pikën 4, të Vendimit nr. 878, datë 30.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së

*pranimit të drejtpërdrejtë edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2015”.*

Nga verifikimi i kryer mbi dokumentin e shpalljes së procedurës së pranimit në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të larë drejtues (TND), rezultoi se ky dokument është bërë publik në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, në rubrikën “Shpallje për pranim të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civile të nivelit të lartë drejtues TND” dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, duke krijuar një mundësi për pjesëmarrje të gjerë, nga brenda dhe jashtë sistemit të shërbimit civil, për këdo kandidat që pretendon se plotëson kushtet e kërkesat specifike të shpalljes.

### **Konkluzione:**

Nga sa analizuam më sipër, rezulton se Departamenti i Administratës Publike është kujdesur që dokumenti i shpalljes të përmbajë të gjitha elementet dhe të dhënat e nevojshme, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit; dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët e aspekte të tjera të kërkuara nga ligji.

Akti i shpalljes, rezulton të përmbajë në pjesën e dytë të tij, kushtet dhe kërkesat e veçanta, aftësitë, njohuritë e cilësitë, që kandidatët (*Nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese, pika 1; Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura, pika 2; Kandidatët nga jashtë shërbimit civil, pika 3*) kërkohet që të zotërojnë për të aplikuar në konkursin për pranim në trupën e nëpunësve civil të nivelit të larë drejtues (TND).

### **III. Aplikimi, verifikimi paraprak dhe publikimi i tij.**

#### **a) Aplikimi**

Nga verifikimi i kryer rezulton se, akti i shpalljes u publikua në portalin zyrtar të Departamentit të Administratës Publike, në rubrikën “Shpallje për pranim të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civile të nivelit të lartë drejtues TND” dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, sipas afatit (*të paktën 60 ditë para datës të planifikuar për zhvillimin e konkurrimit*), sipas përcaktimeve ligjore.

Personat e interesuar (*Nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese, nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura, kandidatët nga jashtë shërbimit civil*), në konkursin kombëtar të pranimit në trupën e nëpunësve civil të nivelit të larë drejtues (TND), që kanë aplikuar brenda afatit 30 ditor nga momenti fillestar i shpalljes në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, janë **72**, aplikantë (*ndër këto, 3 aplikantë për të konkurruar për 1 pozicion “Drejtor i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian” dhe 69 aplikantë për të konkurruar për 29 (njëzet e nëntë) pozicione në trupën e nivelit të lartë drejtues*).



Konstatohet se në këto konkurse kombëtare, megjithëse njësia përgjegjëse (*DAP*) i ka plotësuar detyrimet ngarkuara nga ligji për shërbimin civil dhe aktet e udhëzimet në zbatim të tij, duke krijuar kushtet e nevojshme për një informim sa më të gjerë mbi hapjen e procedurave për praninë në TND, përsëri pjesëmarrja ka qenë e kufizuar, pasi për **30** pozicione, numri aplikimeve ishte **72**.

## **b) Verifikimi paraprak**

Sipas rregullave të vendosura, kalimi nga rubrika “*Aplikant*”, në rubrikën “*Kandidatë të kualifikuar*”, kryhet nëpërmjet fazës së verifikimit paraprak.

Verifikimi paraprak është një fazë para seleksionuese, të cilën bazuar në pikën 8, Kreu IV, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave, e realizon Departamenti i Administratës Publike, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit për dorëzimin e dokumentacioni (*afat i cili është përcaktuar në shpallje*), nga ku aplikantët i nënshtrohen verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar prej tyre, nëse i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme e specifike të përcaktuara në aktin e shpalljes dhe pikave 1 e 2, të Kreut III, të po këtij vendimit.

Verifikimi paraprak mund të klasifikohet në dy nën faza, “*Verifikimi paraprak*” dhe “*Lista përfundimtare*”. Kjo e fundit, ka të bëjë me një procedurë rivefikimi të dosjeve të aplikantëve që nuk janë kualifikuar, nëse ata do të ankohen pranë DAP, brenda 5 ditëve nga shpallja në portal e listës së kandidatëve të kualifikuar (*e drejtë kjo që garantohet nga pika 9, Kreu IV, e VKM më sipër*).

### **• Verifikimi paraprak**

Verifikimi paraprak i konkurrentëve që aplikuan për të marrë pjesë në procedurën e drejtëpërdrejtë të pranimit në trupën e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues (*TND*), për vitin 2015, rezulton të jetë kryer nga Departamenti i Administratës Publike.

Nga kjo fazë paraseleksionuese, nga **3 kandidatë** që aplikuan për të marrë pjesë në konkursin kombëtar për të plotësuar **1** pozicion “*Drejtor i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian*”, u kualifikua vetëm **1 kandidat**.

Nga këqyrja rezultoi se, në përfundim të verifikimit paraprak të konkursit kombëtar për të plotësuar **29** pozicione në trupën e nivelit të lartë drejtues, nga **69 kandidatë** që aplikuan, njësia përgjegjëse vlerësoi të kualifikojë **56 kandidatë** për të vazhduar më tej me fazën e dytë të konkursit.

### **• Lista përfundimtare (pas periudhës 5 ditore të ankimit)**

Nga mbikëqyrja rezulton se kandidatët që nuk janë kualifikuar për të marrë pjesë në konkurrim, janë njoftuan nga Departamenti i Administratës Publike në mënyrë individuale.

Sipas përcaktimeve të pikës 9, Kreu IV, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, ata kanë të drejtë të paraqiten pranë këtij Departamenti për t’u njohur me arsyet e moskualifikimit, si dhe mund të ankohen pranë tij, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e

listës në portalin zyrtar të DAP. Njësia përgjegjëse (DAP), brenda 2 (dy) ditëve pune, duhet të kthejë përgjigje të arsyetuar (nëse është e nevojshme edhe duke rivlerësuar dosjen e kandidatëve).

Në këto konkurrime, konstatohet se, kandidatë të kualifikuar në konkursin kombëtar për të plotësuar *I pozicion “Drejtor i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian”*, në përfundim të rivlerësimit nga ana e njësies përgjegjëse mbas ankimit, ishin 2 kandidatë për të vazhduar fazën e dytë të konkursit.

Kurse, kandidatë të kualifikuar mbas institutit të ankesës në konkursin kombëtar për të plotësuar **29** pozicione në trupën e nivelit të lartë drejtues, ishin 63 kandidatë për të vazhduar fazën e dytë të konkursit.

### **c) Publikimi i verifikimit paraprak dhe listës përfundimtare**

Për të mbikëqyrur respektimin e rregullit të përcaktuar në pikën 8, Kreu IV, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, (*paragrafi i dytë*), dispozitë e cila ngarkon njësien përgjegjëse (DAP) të bëjë publike fazën e verifikimit paraprak për konkurrimet objekt mbikëqyrje, Komisioneri verifikoi Portalin zyrtar të Departamentit të Administratës Publike dhe Portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”.

Nga verifikimi i portaleve më sipër rezultoi se, në përfundim të fazës së verifikimit paraprak, të konkurseve kombëtare për plotësimin e pozicioneve në trupën e nëpunësve civil të nivelit të larë drejtues (TND), për vitin 2015, njësia përgjegjëse ka bërë publike listën e kandidatëve që plotësojnë këto kritere për t’iu nënshtruar konkursit kombëtar (*listën e kandidatëve fitues nga verifikimi paraprak dhe listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar mbas ankesës*), duke i renditur ata sipas rendit alfabetik.

Me përfundimin e procedurës më sipër, njësia përgjegjëse (DAP), në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, ia ka përcjellë Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes, listën e kandidatëve që do t’i nënshtrohen procedurës së konkurrimit.

### **IV. Krijimi, funksioni dhe kompetencat e Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për në trupën e nëpunësve civil të nivelit të larë drejtues (TND).**

Faza e dytë e këtyre konkurrimeve, qëndron në vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, testimin me shkrim dhe në intervistën e strukturuar me gojë. Vlerësimi i fazës së dytë të konkurrimit, sipas përcaktimeve të nenit 29, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe pikës 11, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, i ndryshuar, i Këshillit të Ministrave, bëhet nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes (*në vijim, Komisioni KKP*).

Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët bazuar në rregullin e parashikuar në nenin 31, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar (*Ndryshuar, Neni*

31 shkronjat “a” dhe “b” në pikën 1 me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014) dhe të pikave 2, 3, 7 dhe 8, të Kreut II, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, përzgjidhen në këtë mënyrë:

- a) **1** (një) përfaqësues është, për shkak të detyrës, drejtori i Departamentit të Administratës Publike, i cili kryeson komisionin.
- b) **2** (dy) përfaqësues janë nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, nga të cilët njëri është për shkak të detyrës Drejtori i kësaj shkolle, ndërsa përfaqësuesi i dytë zgjidhet nga drejtori i shkollës (ASPA), me një mandat 2-vjeçar, me kushtin që të plotësojë kriteret dhe kushtet specifike të përcaktuara në pikën 4, të Kreut II, të aktit nënligjor në fjalë.
- c) **1** (një) përfaqësues i TND-së, (i cili zgjidhet me short të organizuar nga DAP-i, nga radhët e anëtarëve të TND-së. Ai qëndron në detyrë për një mandat 2-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme)
- d) **5** (pesë) personalitete të pavarura me përvojë profesionale e integritet dhe që zotërojnë kushtet dhe kriteret specifike të përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, të vendimit më sipër (të cilët, në zbatim të po kësaj pike, emërohen nga Këshilli i Ministrave për një mandat 5-vjeçar).

Emërimi i pesë anëtarëve, është bërë me Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 609, datë 17.09.2014, “Për emërimin e tre anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në” dhe nr. 525, datë 06.08.2014, “Për emërimin e dy anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në”.

Konstatohet se me krijimin e Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND, në cilësinë e organit kolegjal me kompetenca të ngarkuara nga ligji për vlerësimin e kandidatëve në fazën e dytë të këtyre konkurrimeve, sipas përcaktimeve të legjislacionit të shërbimit civil dhe akteve nënligjore e udhëzimeve në bazë dhe për zbatim të tij, ka filluar procedura për zhvillimin e konkurrimeve, objekt mbikëqyrje.

#### **V. Procesi i konkurrimeve dhe shpallja e kandidatëve fitues.**

Ashtu si u shpjegua në kapitullin e mësipërm, Komisioni (KKP), është organi kompetent që realizon vlerësimin e kandidatëve që i nënshtrohen procesit të konkurrimeve, që përfshin vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, (vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore), testimin me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë.

Për realizimin e detyrave të tij, Komisioni (KKP), mbështetet nga ana teknike nga përfaqësuesi i njësisë përgjegjëse (DAP). Ky i fundit ka ngarkuar me funksionet e Sekretariatit Teknik zj. Milena Sauku, duke plotësuar edhe kërkesën ligjore të parashikuar në pikën 19, të Kreut II, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave.

Me përfundimin e fazës së verifikimit paraprak dhe dorëzimit pranë Komisionit (KPP), të listës së kandidatëve të kualifikuar nga ana e njësisë përgjegjëse (DAP), për të vazhduar fazën e dytë të vlerësimit, dhe të përgatitjeve të pyetjeve të testit me shkrim dhe strukturimit të pyetjeve të

intervistës me gojë, rezulton nga ana e Komisionit (KKP), ka vijuar procedura për zhvillimin e testimin me shkrim.

#### a) Testimi me shkrim

Procesi i testimin me shkrim për të pranuar **30** pozicione në trupën e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues (TND), nëpërmjet konkursit kombëtar, nga të cilët **1** (një) pozicion “*Drejtor i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian*”; dhe **29** (njëzet e nëntë) pozicione në trupën e nivelit të lartë drejtues, të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2015, që u zhvillua në datën 16.01.2016, në ambientet e Shkollës të Administratës Publike (ASPA), u monitorua në vend nga inspektorët e autorizuar nga Komisioneri dhe pas përfundimit të tij, rezultoi se:

Fillimisht, anëtarët e Komisionit (KPP) firmosën deklaratën e konfliktit të interesit në bazë të parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit, sipas kushtit që kërkohet për të parandaluar rastet e papajtueshmërisë, parashikuar edhe në pikën 16, të Kreut II, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave.

Testimi me shkrim filloi sipas orarit të përcaktuar në aktin e shpalljes. Për shkak të ambienteve të vogla që Shkolla (ASPA) mundëson, të pa mjaftueshme për të zhvilluar testimin në një klasë, njësia përgjegjëse (DAP), vendosi të akomodojë kandidatët në tre klasa të ndryshme, duke siguruar kushtet e përshtatshme për zhvillimin e testimin.

Për monitorimin e këtij procesi, duke qenë se kandidatët u ndanë në tre klasa, Departamenti administroi procesin monitorues në përputhje me standardet që garanton ligji.

Përpara fillimit të procedurës të testimin, përfaqësuesit e Departamentit, verifikuan praninë e kandidatëve, duke kontrolluar dokumentin e identifikimit të secilit prej tyre, bënë sekretimin e tezave të koduara për secilin kandidat dhe sqaruan kandidatët mbi mënyrën dhe rregulloren se si do të zhvillohej testimi me shkrim.

Në ambientet e zhvillimit të testimin me shkrim, përveç përfaqësuesve të Departamentit, në cilësinë e Sekretariatit Teknik, ishin të pranishëm edhe Kryetari e disa anëtarë të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes, si dhe u vërejt prezenca e medias (*televizioni TVSH*), e cila shtoi nivelin e transparencës së konkurrimit.

Nga një analizë që i është bërë pjesëmarrjes në këtë proces, rezulton se nga **65** kandidat të kualifikuar (**63** kandidatë për të plotësuar **29** pozicione në trupën e nivelit të lartë drejtues dhe **2** kandidatë për të plotësuar **1** (një) pozicion “*Drejtor i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian*”):

- **31** janë nëpunës civil të kategorisë së mesme drejtuese;
- **33** janë nga jashtë shërbimit civil, të ardhur nga shoqëria civile, bota akademike dhe shoqatat e biznesit (*pasi këto konkurse, ashtu si shpjegohet dhe më sipër, ishin të hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil*).

Nga këta kandidatë u paraqitën **58 konkurrentë** për t'iu nënshtruar testimin me shkrim. Teza me shkrim ishte e njëjtë për të dy konkurrimet dhe ishte organizuar në 36 pyetje, për t'iu zhvilluar brenda 4 orëve.

Gjatë kësaj faze, çdo procedurë u realizua normalisht dhe nuk u konstatuan parregullsi.

Me përfundimin e testimin, sekretariati teknik administroi tezat e sekretuara, dhe ia dorëzoi Komisionit (*KKP*) për të vazhduar me vlerësimin e tyre.

#### **b) Intervista e strukturuar me gojë**

Bazuar në numrin e kandidatëve (*58 kandidatë*) intervista e strukturuar me gojë, u organizua në disa ditë, e konkretisht në datat 17, 18 dhe 19 janar, 2016.

Gjatë mbikëqyrjes së fazës së intervistës së strukturuar me gojë, u konstatua se:

- Para zhvillimit të intervistës, Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes zgjodhi nga banka e pyetjeve të krijuara nga Departamenti i Administratës Publike një sërë pyetjesh për të vlerësuar aftësitë dhe cilësitë e kandidatëve, përveç atyre të vlerësuara në testimin me shkrim, duke përcaktuar numrin e pyetjeve dhe mënyrën e llogaritjes;
- Kandidatët nënshkruan deklaratën e pranimit, ose mospranimit për të regjistruar me zë intervistën me gojë;
- Në intervistën e strukturuar me gojë, rezultoi se nga **58 kandidatë** të pranishëm në testimin me shkrim, u paraqitën **55 kandidatë** për t'iu nënshtruar vlerësimin të pyetjeve të Komisionit;
- Secili prej anëtarëve të Komisionit KPP vlerësoi individualisht secilin prej kandidatëve.

Në përfundim të procedurës së konkurrimit, Komisioni (*KPP*), bëri vlerësimin përfundimtar për secilin kandidat, i cili përfshin mbledhjen e pikëve të grumbulluara nga vlerësimi i testimin me shkrim, jetëshkrimit dhe intervistës së strukturuar me gojë, duke njoftuar DAP për renditjen e fituesve me më shumë pikë, deri tek kandidati me **70** pikë.

#### **c) Shpallja e listës së kandidatëve fitues.**

Me ardhjen e listës së kandidatëve fitues nga Komisioni (*KPP*), rezultoi se Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të pikës 11, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, shpalli menjëherë në faqen e tij zyrtare dhe në portalin Kombëtar të Punësimit listën e kandidatëve fitues.

Komisioneri, verifikoi në portalet përkatëse, nga e cila rezultoi se Departamenti i Administratës Publike, ka plotësuar kërkesat ligjore të mësipërme, duke shpallur listën e kandidatëve fitues, si më poshtë:

- **1 kandidat** fitues, për pozicionin, “*Drejtor i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian*”, i cili rezulton të jetë nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues.
- **21 kandidatë** fitues, për pozicione në trupën e nivelit të lartë drejtues, nga të cilët rezultojnë se **9 kandidatë** fitues janë nëpunës civil të nivelit të mesëm drejtues dhe **12 kandidatë** janë nga jashtë shërbimit civil (*që përbëjnë mbi 50% të kandidatëve fitues*).

\* \*

\*

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga Komisioneri gjatë procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (*TND*), për vitin 2015.

➤ **Konkluzione:**

Për sa parashtruam më sipër, pas analizës së të gjitha fazave procedurale për pranimin e drejtpërdrejtë në trupën e nivelit të lartë drejtues (*TND*), Komisioneri arrin në konkluzionin se subjektet kompetentë, të ngarkuar nga ligji (*DAP, ASPA dhe KKP*) për administrimin e kësaj procedure konkurrimi, kanë zbatuar procedurat e përcaktuara në nenin 27, 29, 30 dhe 31, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në Vendimin nr. 118, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave “*Për procedurat e emërimit, rekrutimi, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civile të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND*”, i ndryshuar.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**